



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

V E N D I M

PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMIT PËR NDRYSHIMIN E VENDIT TË NUMËRIMIT TË VOTAVE TË ZAZ-SË NR. 44, QARKU ELBASAN, PËR ZGJEDHJET PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE TË DATËS 30.06.2019

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e datës 28.06.2019, me pjesëmarrjen e:

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare

shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 44, Qarku Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

BAZA LIGJORE: Neni 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur si dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

V Ë R E N

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, me vendimin nr.314 datë 14.05.2019, ka miratuar caktimin e VNV së KZAZ nr.61 në Sallën e Shfaqjeve të Qendrës Kulturore "Ferdinand Deda" Peqin, me sipërfaqe 300 m².

Prefekti i qarkut Elbasan me shkresën nr.12600 datë 28.06.2019, propozon ndryshimin e vendndodhjes së VNV-së së ZAZ nr. 44 duke e caktuar në Pallatin e Sportit "Tomorr Sinani" Elbasan, me sipërfaqe mb 1000 m².

Ndryshimi kërkohet me qëllim shmangien e problematikave dhe realizimin e qetë të procesit zgjedhor të datës 30.06.2019, pasi Bashkia Peqin, ka kërkuar lirim të ambjenteve që janë në administrim të saj.



Nr. 923 i Vendimit Data 28.06.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 44, Qarku Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019

Ambienti i propozuar plotëson kriteret e parashikuara në nenin 93 dhe 94 të Kodit Zgjedhor "Në përcaktimin e Vendit të Numërimit të Votave KQZ-ja mund të përzgjedhë bashkinë qendër qarku, pavarësisht nëse ndodhet jashtë juridiksionit territorial të ZAZ-së, ose bashkinë brenda territorit të ZAZ-së apo edhe njësinë më të madhe administrative, nëse bashkitë nuk i plotësojnë kushtet e parashikuara në nenin 93 dhe në këtë nen".

ZAZ-ja nr. 44 ka në juridiksionin e saj 53 QV, dhe në bazë të përcaktimeve të Udhëzimit të KQZ-së nr. 4, datë 9.04.2015, duhet të ketë sipërfaqe jo më të vogël se 200 m².

PËR KËTO ARSYE

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, bazuar në nenin 23, pika 1 germa "a", nenin 93 dhe 94, pika 1 të ligjit Nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar:

V E N D O S I

1. Të caktojë Vendin e Numërimit të Votave të ZAZ-së nr. 44, në Pallatin e Sportit "Tomorr Sinani" me, sipërfaqe mbi 1000 m², Bashkia Elbasan.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Klement	ZGURI	Kryetar
Denar	BIBA	Zëvendëskryetar
Bledar	SKËNDERI	Anëtar
Edlira	JORGAQI	Anëtare
Rezarta	BITRI	Anëtare



Nr. 923 i Vendimit Data 28.06.2019 e Vendimit Ora 18:00 e Vendimit

Për shqyrtimin e propozimit për ndryshimin e vendit të numërimit të votave të zaz-së nr. 44, Qarku Elbasan, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 30.06.2019